

# BULETINI PERIODIK I PRAKTIKËS GJYQËSORE

# PERIODIČNI BILTEN SUDSKE PRAKSE

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE**
**USTAVNI SUD**
**CONSTITUTIONAL COURT**

**PRILL – QERSHOR**

**APRIL - JUN**

**2024**

II

**Buletini periodik i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese**

(Prill - Qershor 2024)

Buletini periodik i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese përmban përmbledhjen e aktgjykimeve dhe aktvendimeve me rëndësi dhe interes të veçantë, të cilat janë publikuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) gjatë periudhës së fundit tre (3) mujore.

Me qëllimin për ta bërë sa më të qartë për lexuesit natyrën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, aktgjykimet dhe aktvendimet janë klasifikuar sipas pretendimeve të bazuara në nenet specifike të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Buletini periodik i praktikës gjyqësore është një dokument që publikohet në baza periodike dhe publikohet nga Sekretaria e Gjykatës vetëm për çështje informative.

Tekstet e plota të aktgjykimeve dhe të aktvendimeve të përfshira në këtë Buletin janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe mund t'i gjeni të publikuara edhe në ueb-faqen e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org

Për të pranuar Buletinin periodik të praktikës gjyqësore në postën tuaj elektronike, ju lutemi të regjistroheni në ueb-faqen e Gjykatës:

www.gjk-s.org/publication_category/buletini-periodik

***Vërejtje:*** *Kushdo që dëshiron të kopjojë, përkthejë apo shfrytëzojë për qëllime të tjera të gjitha ose një pjesë të informacioneve të përmbajtura në Buletin, duhet të kontaktojë Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese për udhëzime të mëtutjeshme.*

**Periodični bilten sudske prakse Ustavnog suda**

(April– Jun 2024. godine)

Periodični bilten sudske prakse Ustavnog suda sadrži sažetke presuda i rešenja od posebnog značaja i interesa, koje je Ustavni sud Republike Kosovo (u daljem tekstu: Sud) objavio u poslednja tri (3) meseca.

Kako bi se čitaocima učinila što jasnijom priroda odluka Ustavnog suda, presude i rešenja su klasifikovani prema navodima zasnovanim na određenim članovima Ustava Republike Kosovo (u daljem tekstu: Ustav).

Periodični bilten sudske prakse je dokument koji se objavljuje periodično, a Sekretarijat suda ga priprema samo u informativne svrhe.

Kompletni tekstovi presuda i rešenja sadržanih u ovom Biltenu objavljeni su u Službenom listu Republike Kosovo, a mogu se naći i na internet stranici Ustavnog suda:

www.gjk-ks.org

Da biste primali Periodični bilten sudske prakse na svoju adresu elektronske pošte, molimo vas registrujte se na internet stranici Suda:

https://gjk-ks.org/sr/publication_category/periodicni-bilten/

***Napomena:*** *Svako ko želi da kopira, prevede ili za druge svrhe koristi sve ili deo informacija sadržanih u ovom Biltenu treba da kontaktira Sekretarijat Ustavnog suda za dalja uputstva.*

"Perandori Justinian" nr. 44, 10 000 Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 60 61 62
Mob: +383(0) 45 200 595; +383(0) 45 200 576
Fax: +383(0) 38 60 61 70
Email: gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org
©Gjykata Kushtetuese 2024

Tabela e përmbajtjes/Pregled sadržaja

**I - Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**
**I - Član 31 [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]**

***(i) E drejta për "qasje në gjykatë"***
***(i) Pravo na "pristup sudu"***

- Llogaritja e pasaktë e afateve të përcaktuara me Ligjin e Punës nga ana e Gjykatës Supreme, rezultoi në mohimin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

  -shkelje e të drejtave kushtetuese.

- Netačno računanje rokova koje je utvrdio Zakon o radu od strane Vrhovnog suda, rezultiralo je uskraćivanjem prava podnosioca zahteva na pristup sudu, kao sastavnog dela prava na pravično i nepristrasno suđenje.

  -povreda ustavnih prava.

KI38/23, parashtrues: *Flamur Dylhasi,* Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev.nr.205/2022], të 10 tetorit 2022.............6

KI38/23, *podnosilac zahteva: Flamur Dylhasi,* Ocena ustavnosti rešenja Vrhovnog suda Republike Kosovo [Rev. br. 205/2022] od 10. oktobra 2022. Godine....................................6

- Mosshqyrtimi i ankesës së parashtruesve të kërkesë në merita nga Gjykata e Apelit, rezultoi në pamundësinë e shqyrtimit të thelbit të pretendimeve të tyre të ngritura në ankesë para kësaj gjykate.

  -shkelje e të drejtave kushtetuese.

- Nerazmatranje žalbe podnosilaca zahteva u meritumu od strane Apelacionog suda, rezultiralo je do nemogućnosti razmatranja suštine njihovih navoda iznesenih u žalbi pred ovim sudom.

  -povreda ustavnih prava.

KI121/22, parashtrues: *Mexhid Asllani, Ekrem Asllani dhe Nuredin Xhaferi,* Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev. nr. 434/2022] të 24 majit 2022 për plotësimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [Rev. nr. 426/2021] të 29 qershorit 2021 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 1148/2018], të 4 marsit 2020..................................................8

KI121/22, *podnosilac zahteva: Mexhid Asllani, Ekrem Asllani i Nuredin Xhaferi*, Ocena ustavnosti rešenja [Rev. br. 434/ 2022] od 24. maja 2022. godine za dopunu presude [Rev. br. 426/ 2021] Vrhovnog suda od 29. juna 2021. godine i presude [Ac. br. 1148/ 2018] Apelacionog suda od 4. marta 2020. godine...........................................................................8

### *(ii) Pretendimi nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm*
### *(ii) Navod nije više aktivno sporan*

- Në kontekst të vlerësuarit nëse ende qëndrojnë rrethanat për të cilat parashtruesja e kërkesës është ankuar në Gjykatë, kjo e fundit konsideroi se në rrethanat e rastit konkret objekti i kërkesës nëse parashtruesja është viktimë e shkeljes së të drejtave të saja si rezultat i Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm për arsye se i njëjti është anuluar përmes Aktvendimit të Gjykatës Supreme, të 7 qershorit 2023, dhe çështja e kërkesëpadisë së saj është kthyer në rigjykim në Gjykatën Themelore.
- U kontekstu ocene da li su i dalje održive okolnosti zbog kojih se podnositeljka zahteva žalila Sudu, poslednje navedeni je smatrao da u okolnostima konkretnog slučaja predmet zahteva da li je podnositeljka zahteva žrtva povrede njenih prava kao rezultat osporene presude Apelacionog suda više nije aktivno sporan zbog činjenice da je ukinut rešenjem Vrhovnog suda od 7. juna 2023. godine, a pitanje njenog tužbenog zahteva je vraćeno Osnovnom sudu na ponovno suđenje.

KI70/23, parashtruese: *Xhemile Ademi*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës [Ae. Nr. 835/19], të 11 nëntorit 2022......................................10

KI70/23, podnositeljka zahteva: *Xhemile Ademi*, Ocena ustavnosti presude [Ae. br. 835/19] Apelacionog suda Kosova od 11. novembra 2022. godine......................................................10

## II - Neni 24 [Barazia para Ligjit]

## II - Član 24 [Jednakost pred zakonom]

### *(iii) Mosshterim i mjeteve juridike*
### *(iii) Neiscrpljivanje pravnih sredstava*

- Aktet nënligjore, sikurse edhe Rregullorja e kontestuar e Bankës Qendrore nga ana e parashtruesit të kërkesës, i nënshtrohen kontrollit administrativ nga gjykatat e rregullta dhe që këto të fundit, kanë juridiksion të plotë që të vlerësojnë ligjshmërinë e akteve të tilla:

  -Kërkesë e papranueshme si rezultat i mosshterimit të mjeteve juridike
- Podzakonski akti, kao i osporena Uredba Centralne banke od strane podnosioca zahteva, podležu administrativnoj kontroli redovnih sudova i poslednje navedeni imaju punu nadležnost da ocenjuju zakonitost takvih akata:

  - Neprihvatljiv zahtev zbog neiscrpljivanja pravnih sredstava.

KI42/24, parashtrues: *Vasilije Arsić,* Vlerësim i kushtetutshmërisë së Rregullores së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për operacionet me para të gatshme.............................12

KI42/24, podnosilac zahteva: *Vasilije Arsić*, Ocena ustavnosti Uredbe Centralne banke Republike Kosovo o gotovinskim operacijama....................................................................12

## Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

KI38/23, parashtrues *Flamur Dylhasi*, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev.nr.205/2022], të 10 tetorit 2022

Llogaritja e pasaktë e afateve të përcaktuara me Ligjin e Punës nga ana e Gjykatës Supreme, rezultoi në mohimin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

-shkelje e të drejtave kushtetuese.

### *Faktet*

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontest nga marrëdhënia e punës. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, (i) parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontratë pune me Byronë Kosovare të Sigurimeve (BKS), për kohë të caktuar, përkatësisht nga 1 korriku 2015 deri më 30 qershor 2016; (ii) në shkurt të vitit 2016, BKS kishte nxjerrë Vendimin [nr. 331/16], me të cilin parashtruesit të kërkesës i ishte shkëputur kontrata e punës, për të cilin i njëjti u njoftua më 10 mars 2016; dhe (iii) parashtruesi i kërkesës, më 21 mars 2016, ishte ankuar në organet e BKS-së, por nuk kishte marrë përgjigje dhe për pasojë, më 4 maj 2016, kishte ushtruar kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Kjo e fundit kishte aprovuar kërkesëpadinë tij dhe kishte anuluar në tërësi Vendimin [nr. 331/16] e BKS-së, vendimmarrje kjo që ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit pas ankesës së BKS-së. Megjithatë, Gjykata Supreme, duke vepruar sipas kërkesës për revizion të BKS-së, përmes Aktvendimit të kontestuar ndryshoi Aktgjykimet e instancave të shkallës më të ulët, duke konstatuar se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës ishte ushtruar jashtë afatit prej tridhjetë (30) ditëve të parashikuar me nenin 79 (Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë) të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

### *Pretendimet e parashtruesit të kërkesës*

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Kushtetuese kontestuan Aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Supreme, duke pretenduar shkeljen e

## Član 31. [ Pravo na pravično i nepristrasno suđenje ]

KI38/23, podnosilac zahteva *Flamur Dylhasi*, Ocena ustavnosti rešenja Vrhovnog suda Republike Kosovo [Rev. br. 205/2022] od 10. oktobra 2022. godine

Netačno računanje rokova koje je utvrdio Zakon o radu od strane Vrhovnog suda, rezultiralo je uskraćivanjem prava podnosioca zahteva na pristup sudu, kao sastavnog dela prava na pravično i nepristrasno suđenje.

-povreda ustavnih prava

### *Činjenice*

Okolnosti konkretnog slučaja tiču se spora iz radnog odnosa. Prema pojašnjenjima koja su data u presudi, (i) podnosilac zahteva je sa Kosovskim uredom osiguranja (KUO) zaključio ugovor o radu na neodređeno vreme, odnosno za period od 1. jula 2015. do 30. juna 2016. godine; (ii) u februaru 2016. godine, KUO je doneo odluku [br. 331/16], kojom je podnosiocu zahteva otkazan ugovor o radu, sa kojom je isti upoznat 10. marta 2016. godine; i (iii) podnosilac zahteva se, dana 21. marta 2016. godine, žalio organima KUO-a, ali nije dobio odgovor i kao rezultat toga, on je, dana 4. maja 2016. godine, podneo tužbeni zahtev Osnovnom sudu u Prištini. Poslednje pomenuti je usvojio njegov tužbeni zahtev i ukinuo u celosti odluku [br. 331/16] KUO-a, a ovo odlučivanje je potvrđeno i od strane Apelacionog suda nakon žalbe KUO-a. Međutim, Vrhovni sud je postupajući po zahtevu za reviziju KUO-a, osporenim rešenjem preinačio nižestepene presude, utvrdivši da je tužbeni zahtev podnosioca zahteva podnet van roka od trideset (30) dana koji je predviđen članom 79. (Zaštita zaposlenog na sudu) Zakona br. 03/L-212 o radu.

### *Navodi podnosioca zahteva*

Podnosilac zahteva je pred Ustavnim sudom osporio gore navedeno rešenje Vrhovnog suda, tvrdeći da je povređeno njegovo pravo na

të drejtës së tyre për gjykim të drejtë dhe paanshëm të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në esencë, duke argumentuar cenimin e të drejtës për qasje në gjykatë ka ardhur si rezultat i llogaritjes së gabuar të Gjykatës Supreme të afatit mbi parashtrimin e kërkesëpadisë në gjykatën e shkallës së parë.

*Vlerësimi i Gjykatës*

Gjykata fillimisht (i) shtjelloi parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me parimin e qasjes në gjykatë, dhe (ii) më pas, i aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret, duke rikujtuar që në parim, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nuk reflekton vetëm të drejtën për të filluar procedura por edhe të drejtën për të marrë një zgjidhje të kontestit përkatës nga një gjykatë, për aq sa aspektet përkatëse procedurale janë ndjekur bazuar në ligjet e aplikueshme. Në këtë aspekt, Gjykata vërejti se parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në ditën e tridhjetë (30) kalendarike, më 4 maj 2016, përkatësisht pasi kishte kaluar afati pesëmbëdhjetë (15) ditor për të marr përgjigje për ankesën e ushtruar më 21 mars 2016 në organet e BSK-së, afat i cili ligjërisht do të përfundonte më 4 prill 2016. Nga kjo datë, sipas këndvështrimit të Gjykatës, parashtruesi i kërkesës kishte në dispozicion edhe tridhjetë (30) ditë afat shtesë, gjegjësisht deri më 4 maj 2016, për të parashtruar kërkesëpadinë në Gjykatën Themelore kundër vendimit të punëdhënësit, gjë të cilën e kishte bërë, në pajtueshmëri të plotë me afatet e përcaktuara me nenet 78 (Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit), dhe 79 (Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë) të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

*Përfundimi*

Gjykata konstatoi se vendimi për ndryshimin e aktgjykimeve të gjykatave të shkallës më të ulët, që ishin në favor të parashtruesit të kërkesës, bazuar në llogaritje të pasaktë të afateve të përcaktuara në Ligjin e Punës, Gjykata Supreme

pravično i nepristrasno suđenje zagarantovano članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava u vezi sa članom 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima, argumentujući, u suštini, da je do povrede prava na pristup pravdi došlo kao rezultat toga što je Vrhovni sud pogrešno izračunao rok za podnošenje tužbenog zahteva prvostepenom sudu.

*Ocena Suda*

Sud je najpre (i) razradio opšta načela svoje sudske prakse i sudske prakse Evropskog suda za ljudska prava u pogledu načela pristupa pravdi i (ii) nakon toga, primenio ista na okolnosti konkretnog slučaja, podsetivši da u principu, pravo na pravično i nepristrasno suđenje ne obuhvata samo pravo na pokretanje postupka, već i pravo da se dobije rešenje datog spora od strane suda, ukoliko su ispoštovani relevantni procesni aspekti na osnovu primenljivih zakona. U tom aspektu, Sud je primetio da je podnosilac zahteva podneo tužbeni zahtev Osnovnom sudu tridesetog (30.) kalendarskog dana, 4. maja 2016. godine, odnosno po isteku roka od petnaest (15) dana za dobijanje odgovora na žalbu koja je, dana 21. marta 2016. godine, izjavljena organima KUO-a, koji rok bi po zakonu istekao 4. aprila 2016. godine. Od ovog datuma, prema stanovištu Suda, podnosilac zahteva je imao na raspolaganju još trideset (30) dana dodatnog roka, odnosno do 4. maja 2016. godine, da podnese tužbeni zahtev Osnovnom sudu protiv odluke poslodavca, što je on i uradio, u potpunoj saglasnosti sa rokovima utvrđenim odredbama člana 78. (Zaštita prava zaposlenih) i 79. (Zaštita zaposlenog na sudu) Zakona br. 03/L-212 o radu.

*Zaključak*

Sud je utvrdio da je odluka o preinačenju presuda nižestepenih sudova, koje su išle u korist podnosioca zahteva, na osnovu netačnog izračunavanja rokova utvrđenih Zakonom o radu, Vrhovni sud uskratio istom pravo na pristup

ia mohoi atij të drejtën për qasje në gjykatë dhe zgjidhje efektive të kontestit. Rrjedhimisht, Gjykata konkludoi se Aktvendimi [Rev. nr. 205/2022] i Gjykatës Supreme të Republikës Kosovës, i 10 tetorit 2022, nuk është në pajtueshmëri me të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

KI121/22, parashtrues *Mexhid Asllani, Ekrem Asllani dhe Nuredin Xhaferi,* Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev. nr. 434/2022] të 24 majit 2022 për plotësimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [Rev. nr. 426/2021] të 29 qershorit 2021 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 1148/2018], të 4 marsit 2020

Mosshqyrtimi i ankesës së parashtruesve të kërkesë në merita nga Gjykata e Apelit, rezultoi në pamundësinë e shqyrtimit të thelbit të pretendimeve të tyre të ngritura në ankesë para kësaj gjykate.

-shkelje e të drejtave kushtetuese

*Faktet*

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontest civil mes parashtruesve të kërkesës dhe kompanisë së sigurimeve “Sigal Uniqua Group Austria” në lidhje me një aksident komunikacioni që kishte ndodhur në magjistralen Ferizaj – Kaçanik, nga i cili parashtruesit e kërkesës pësuan lëndime trupore. Si rezultat, parashtruesit e kërkesës, më 15 korrik 2015, parashtruan kërkesëpadi për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial në Gjykatën Themelore në Ferizaj. Kjo e fundit kishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e tyre, duke akorduar për secilin prej parashtruesve një vlerë monetare të caktuar. Të pakënaqur me vlerën e kompensimit, parashtruesit e kërkesës dhe *“Sigal Uniqua Group Austria”* e kishin paraqitur ankesparaqitur ankesë në Gjykatën e Apelit. Kjo e fundit, më 4 mars 2020, kishte vendosur vetëm përkitazi me ankesën e të paditurës “Sigal Uniqua Group Austria”, por jo edhe për ankesën e parashtruesve të kërkesës. Si rrjedhojë, parashtruesit e kërkesës, por edhe e paditura

sudu i delotvorno rešavanje spora. Shodno tome, Sud je zaključio da rešenje [Rev. br. 205/2022] Vrhovnog suda Republike Kosovo od 10. oktobra 2022. godine nije u saglasnosti sa ustavnim pravima podnosioca zahteva, zagarantovanim članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava u vezi sa članom 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima.

KI121/22, podnosilac zahteva *Mexhid Asllani, Ekrem Asllani i Nuredin Xhaferi,* Ocena ustavnosti rešenja [Rev. br. 434/ 2022] od 24. maja 2022. godine za dopunu presude [Rev. br. 426/ 2021] Vrhovnog suda od 29. juna 2021. godine i presude [Ac. br. 1148/ 2018] Apelacionog suda od 4. marta 2020. godine

Nerazmatranje žalbe podnosilaca zahteva u meritumu od strane Apelacionog suda, rezultiralo je do nemogućnosti razmatranja suštine njihovih navoda iznesenih u žalbi pred ovim sudom.

-povreda ustavnih prava

*Činjenice*

Okolnosti konkretnog slučaja se odnose na građanski spor između podnosilaca zahteva i Osiguravajućeg društva "Sigal Uniqua Group Austria" u vezi sa saobraćajnom nesrećom koja se dogodila na magistralnom putu Uroševac – Kačanik, a u kojoj su podnosioci zahteva zadobili telesne povrede. Kao rezultat toga, podnosioci zahteva su 15. jula 2015. godine podneli tužbeni zahtev Osnovnom sudu u Uroševcu za naknadu materijalne i nematerijalne štete. Poslednje navedeni je delimično usvojio njihov tužbeni zahtev, dosudivši svakom od podnosilaca zahteva određeni novčani iznos. Nezadovoljni iznosom naknade, podnosioci zahteva i *"Sigal Uniqua Group Austria"* su uložili žalbe Apelacionom sudu. Poslednje navedeni je 4. marta 2020. godine odlučio samo povodom žalbe tuženog "Sigal Uniqua Group Austria", ali ne i povodom žalbe podnosilaca zahteva. Kao rezultat toga, podnosioci zahteva, ali i tuženi "Sigal Uniqua Group Austria" su podneli reviziju Vrhovnom sudu. Taj sud je,

"Sigal Uniqua Group Austria", parashtruan revizion në Gjykatën Supreme. Kjo e fundit, më 29 qershor 2021, nxori Aktgjykimin [Rev. nr. 426/2021] përmes të cilit refuzoi në tërësi revizionin e të paditurës "Sigal Uniqua Group Austria", por nuk vendosi sërish lidhur me kërkesën për revizion të parashtruesve të kërkesës. Këta të fundit, u drejtuan sërish Gjykatës Supreme dhe për pasojë, e njëjta nxori Aktvendim plotësues [Rev. nr. 434/2022], më 24 maj 2022, përmes të cilit hodhi poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesve të kërkesës, për shkak të vlerës së kontestit nën shumën prej tre mijë (3,000) euro për secilin parashtrues.

*Pretendimet e parashtruesit të kërkesës*

Parashtruesit e kërkesës para Gjykatës Kushtetuese kontestuan vendimet e lartcekura, duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në esencë, parashtruesit pretenduan cenimin e të drejtës së tyre për "qasje në gjykatë" nga ana e (i) Gjykatës së Apelit, për shkak të mos shqyrtimit të ankesës së tyre; dhe (ii) Gjykatës Supreme, për shkak të mos marrjes në shqyrtim të pretendimit thelbësor për mohimin e drejtësisë dhe të mjetit juridik nga Gjykata e Apelit

*Vlerësimi i Gjykatës*

Gjykata fillimisht (i) shtjelloi parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me parimin e qasjes në drejtësi; dhe (ii) më pas i aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret, duke rikujtuar që, në parim, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, gjegjësisht për qasje në drejtësi, nuk reflekton vetëm të drejtën për të filluar procedura, por edhe të drejtën për të marrë një zgjidhje të kontestit përkatës nga një gjykatë e pavarur e themeluar me ligj. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht shqyrtoi pretendimet e parashtruesve të kërkesës përkitazi me shkeljen e të drejtës për qasje në drejtësi nga ana e Gjykatës së Apelit, duke arritur në përfundimin se kjo e fundit, duke mos e trajtuar fare ankesën e 31 gushtit 2017, as

29. juna 2021. godine, doneo presudu [Rev. br. 426/2021], kojom je odbio u celosti reviziju tuženog "Sigal Uniqua Group Austria", ali ponovo nije odlučio povodom zahteva za reviziju podnosilaca zahteva. Poslednje navedeni su se ponovo obratili Vrhovnom sudu i kao rezultat toga, Vrhovni sud je doneo dopunsko rešenje [Rev. br. 434/2022] od 24. maja 2022. godine, kojim je odbacio, kao nedozvoljenu, reviziju podnosilaca zahteva zbog vrednosti spora koja je bila niža od iznosa od tri hiljade (3.000) evra za svakog podnosioca zahteva.

*Navodi podnosioca zahteva*

Podnosioci zahteva su pred Ustavnim sudom osporili gore navedene odluke, tvrdeći da su im povređena prava zagarantovana članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] u vezi sa stavom 1. člana 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima. U suštini, podnosioci zahteva su tvrdili da je došlo do povrede njihovog prava na "pristup pravdi" od strane (i) Apelacionog suda zbog nerazmatranja njihove žalbe; i (ii) Vrhovnog suda zbog nesagledavanja suštinskog navoda o uskraćivanju pravde i pravnog sredstva od strane Apelacionog suda.

*Ocena Suda*

Sud je prvo (i) razradio opšta načela svoje sudske prakse i sudske prakse Evropskog suda za ljudska prava u pogledu načela pristupa pravdi; i (ii) nakon toga primenio ista na okolnosti konkretnog slučaja, podsetivši da, u principu, pravo na pravično i nepristrasno suđenje, odnosno na pristup pravdi, ne odražava samo pravo na pokretanje postupka, već i pravo na dobijanje rešenja datog spora od strane nezavisnog suda ustanovljenog zakonom. U ovom aspektu, Sud je najpre razmotrio navode podnosilaca zahteva koji se odnose na povredu prava na pristup sudu od strane Apelacionog suda, zaključivši da je taj sud, time što uopšte nije razmotrio žalbu od 31. godine 2017. godine, ni presudom [Ac. br. 1148/2018]

me Aktgjykimin [Ac. nr. 1148/2018] e 4 marsit 2020 dhe as me ndonjë vendim të veçantë, ua kishte pamundësuar parashtruesve të kërkesës shqyrtimin e thelbit të pretendimeve të ngritura në ankesë, kundër Aktgjykimit përkatës të Gjykatës Themelore.

### Përfundimi

Gjykata konkludoi se Aktvendimi [Rev. nr. 434/2022] i 24 majit 2022, për plotësimin e Aktgjykimit [Rev. nr. 426/2021] të 29 qershorit 2021 të Gjykatës Supreme, dhe Aktgjykimi [Ac. nr. 1148/2018] i 4 marsit 2020 i Gjykatës së Apelit janë nxjerrë në shkelje të të drejtave kushtetuese të parashtruesve të kërkesës, të garantuara me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### KI70/23, parashtruese *Xhemile Ademi*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës [Ae. Nr. 835/19], të 11 nëntorit 2022

Në kontekst të vlerësuarit nëse ende qëndrojnë rrethanat për të cilat parashtruesja e kërkesës është ankuar në Gjykatë, kjo e fundit konsideroi se në rrethanat e rastit konkret objekti i kërkesës nëse parashtruesja është viktimë e shkeljes së të drejtave të saja si rezultat i Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm për arsye se i njëjti është anuluar përmes Aktvendimit të Gjykatës Supreme, të 7 qershorit 2023, dhe çështja e kërkesëpadisë së saj është kthyer në rigjykim në Gjykatën Themelore.

### *Faktet*

Më 28 nëntor 1999, bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës, kishte ndërruar jetë si pasojë e lëndimeve të marra në punë, në Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK). KEK-u, bashkëshortes së të ndjerit dhe pasardhësve të tij, iu kompensoi rentën mujore në periudhë prej pesë (5) vitesh, më pas duke e ndërprerë të njëjtën në mënyrë të njëanshme më 1 korrik 2006. Parashtruesja e kërkesës, në vitin 2006 kishte paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Vushtrri, e cila procedurë kishte

od 4. marta 2020. godine, niti nekom posebnom odlukom, onemogućio podnosiocima zahteva razmatranje suštine navoda iznesenih u žalbi, protiv relevantne presude Osnovnog suda.

### Zaključak

Sud je već zaključio da su rešenje [Rev. br. 434/2022] od 24. maja 2022. godine za dopunu presude [Rev. br. 426/2021] Vrhovnog suda, od 29. juna 2021. godine, i presuda [Ac. br. 1148/2018] Apelacionog suda od 4. marta 2020. godine donete uz povredu prava podnosilaca zahteva koja su zagarantovana stavom 1, člana 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava, u vezi sa stavom 1, člana 6. [Pravo na pravično suđenje] Evropske konvencije o ljudskim pravima.

### KI70/23 podnositeljka zahteva *Xhemile Ademi*, Ocena ustavnosti presude Ae. br. 835/19 Apelacionog suda Kosova od 11. novembra 2022. godine

U kontekstu ocene da li su i dalje održive okolnosti zbog kojih se podnositeljka zahteva žalila Sudu, poslednje navedeni je smatrao da u okolnostima konkretnog slučaja predmet zahteva da li je podnositeljka zahteva žrtva povrede njenih prava kao rezultat osporene presude Apelacionog suda više nije aktivno sporan zbog činjenice da je ukinut rešenjem Vrhovnog suda od 7. juna 2023. godine, a pitanje njenog tužbenog zahteva je vraćeno Osnovnom sudu na ponovno suđenje.

### *Činjenice*

Dana 28. novembra 1999. godine, suprug podnositeljke zahteva preminuo od posledica povreda zadobijenih na radu u Energetskoj korporaciji Kosova (u daljem tekstu: EKK). EKK je supruzi pokojnog i njegovim potomcima nadoknadio mesečnu rentu u trajanju od pet (5) godina, a zatim je prekinuo jednostrano, dana 1. jula 2006. godine. Podnositeljka zahteva je 2006. godine podnela tužbeni zahtev Opštinskom sudu u Vučitrnu, čiji je postupak rezultirao donošenjem presude

rezultuar në nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 11 tetorit 2018, përmes së cilit kërkesëpadia e saj ishte refuzuar si e pabazuar për shkak se e njëjta ishte parashkruar. Si rezultat i ankesës së parashtrueses së kërkesës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit kjo e fundit përmes Aktgjykimit të kontestuar [Ae. Nr. 835/19] të 11 nëntorit 2022 kishe refuzuar ankesën e saj si të pathemeltë.

### *Pretendimet e parashtrueses së kërkesës*

Parashtruesja e kërkesës më 27 mars 2023 dorëzoi kërkesën e saj në Gjykatën Kushtetuese, përmes të cilës kishte kontestuar Aktgjykimin [Ae.nr.835/19] të Gjykatës së Apelit, të 11 nëntorit 2022, duke pretenduar se i njëjti shkel të drejtat e saj të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

Gjykata u njoftua se (i) parashtruesja e kërkesës përmes përfaqësuesit të saj ligjor, para se të dorëzonte kërkesën e saj në Gjykatën Kushtetuese, më 22 shkurt 2022 kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme kishte parashtruar revizion; dhe (ii) kjo e fundit përmes Aktvendimit [Rev. nr. 211/2023] të 7 qershorit 2023, kishte pranuar revizionin e saj si të bazuar dhe për pasojë kishte anuluar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, të 11 nëntorit 2022, duke e kthyer lëndën në rigjykim në Gjykatën Themelore. Në rastin konkret, në kontekst të vlerësuarit nëse ende qëndrojnë rrethanat për të cilat parashtruesja e kërkesës është ankuar në Gjykatë, kjo e fundit konsideroi se në rrethanat e rastit konkret objekti i kërkesës nëse parashtruesja është viktimë e shkeljes së të drejtave të saja si rezultat i Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm për arsye se i njëjti është anuluar përmes Aktvendimit të Gjykatës Supreme, të 7 qershorit 2023, dhe çështja e kërkesëpadisë së saj është kthyer në rigjykim në Gjykatën Themelore.

Osnovnog suda u Prištini, 11. oktobra 2018. godine, kojom je njen tužbeni zahtev odbijen kao neosnovan jer je isti zastareo. Kao rezultat žalbe podnositeljke zahteva podnete protiv presude Osnovnog suda, Apelacionom sudu, ovaj poslednje navedeni je osporenom presudom [Ae. br. 835/19] od 11. novembra 2022. godine, odbio njenu žalbu kao neosnovanu.

### *Navodi podnosioca zahteva*

Podnositeljka zahteva je 27. marta 2023. godine podnela zahtev Ustavnom sudu, kojim je osporila presudu [Ae. br. 835/19] od 11. novembra 2022. godine Apelacionog suda, navodeći da su joj istom povređena prava zagarantovana članom 31. Pravo na pravično i nepristrasno suđenje Ustava.

### Ocena Suda

Sud je informisan da (i) je podnositeljka zahteva preko svog pravnog zastupnika, pre podnošenja zahteva Ustavnom sudu, dana 22. februara 2022. godine protiv rešenja Apelacionog suda podnela reviziju Vrhovnom sudu; i (ii) Vrhovni sud je kroz rešenje [Rev. br. 211/2023] od 7. juna 2023. godine, usvojio reviziju kao osnovanu i shodno tome poništio osporenu presudu Apelacionog suda od 11. novembra 2022. godine, tako što je predmet vratio Osnovnom sudu na ponovno suđenje. U konkretnom slučaju, u kontekstu procene da li okolnosti zbog kojih se podnositeljka zahteva žalila Sudu i dalje postoje, Ustavni sud je smatrao da je u okolnostima konkretnog slučaja predmetna stvar da li je podnositeljka zahteva žrtva povrede njenih prava kao rezultat osporene presude Apelacionog suda od 11. novembra 2022. godine, više nije aktivno sporna jer je rešenjem Vrhovnog suda od 07. juna 2023. godine ista poništena, a pitanje njenog tužbenog zahteva je vraćeno Osnovnom sudu na ponovno suđenje.

*Përfundimi*

Si përfundim, Gjykata bazuar në pikën (a), paragrafin 1 të rregullit 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës vendosi që kërkesën e parashtrueses së kërkesës ta hedhë poshtë në procedurë të shkurtër, për shkak se pretendimet saja në lidhje me Aktgjykimin e anuluar të 11 nëntorit 2022, të Gjykatës së Apelit nga Gjykata Supreme "nuk janë më në mënyrë aktive të diskutueshme para saj."

*Zaključak*

Shodno tome, Sud je na osnovu tačke (a), stava 1 pravila 54. (Odbacivanje i odbijanje zahteva) Poslovnika o radu odlučio da zahtev podnositeljke odbaci po kratkom postupku, jer njeni navodi povodom presude Apelacionog suda od 11. novembra 2022. poništene od strane Vrhovnog suda „*nisu više aktivno sporni pred njim*“.

## Neni 24 [Barazia para Ligjit]

## Neni 24 [Jednakost pred zakonom]

### KI42/24, parashtrues *Vasilije Arsić*, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Rregullores së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për operacionet me para të gatshme

Aktet nënligjore, sikurse edhe Rregullorja e kontestuar e Bankës Qendrore nga ana e parashtruesit të kërkesës, i nënshtrohen kontrollit administrativ nga gjykatat e rregullta dhe që këto të fundit, kanë juridiksion të plotë që të vlerësojnë ligjshmërinë e akteve të tilla:

-Kërkesë e papranueshme, mosshterim i mjeteve juridike

*Faktet*

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me miratimin e Rregullores për Operacionet me Para të Gatshme nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, sipas nenit 35 (Valuta euro) të së cilës, është përcaktuar që (i) valuta e vetme e lejuar të përdoret për kryerjen e transaksioneve të pagesave me para të gatshme në sistemin e pagesave në Republikën e Kosovës është euro, si valutë e vetme në kuptim të nenit 11 [Valuta] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neneve 16 (Emetimi i valutës), 17 (Këmbimi i kartëmonedhave dhe monedhave të euros) dhe 18 (Kartëmonedhat dhe monedhat e euros të dëmtuara) të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës; dhe (ii) Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është

### KI42/24, podnosilac zahteva *Vasilije Arsić*, Ocena ustavnosti Uredbe Centralne banke Republike Kosovo o gotovinskim operacijama

Podzakonski akti, kao i osporena Uredba Centralne banke od strane podnosioca zahteva, podležu administrativnoj kontroli redovnih sudova i poslednje navedeni imaju punu nadležnost da ocenjuju zakonitost takvih akata:

- Neprihvatljiv zahtev zbog neiscrpljivanja pravnih sredstava

*Činjenice*

Okolnosti konkretnog slučaja se odnose na usvajanje Uredbe o gotovinskim operacijama od strane Odbora Centralne banke Republike Kosovo, shodno članu 35. (Evro valuta), kojim se utvrđuje da je (i) jedina valuta koja se može koristiti za obavljanje gotovinskih platnih transakcija u platnom sistemu u Republici Kosovo evro, kao jedina valuta u smislu člana 11. [Valuta] Ustava Republike Kosovo i člana 16. (Izdavanje valuta), 17. (Razmena evro novčanica i kovanica) i 18. (Oštećene evro novčanice i kovanice) Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo; i (ii) Centralna banka Republike Kosovo je jedini monetarni organ koji može odlučiti o dozvoljenim apoenima valute evra za promet u Republici Kosovo.

autoriteti i vetëm monetar që mund të vendosë për denominimet e lejuara të valutës euro për qarkullim në Republikën e Kosovës.

*Pretendimet e parashtruesit të kërkesës*

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës kontestoi kushtetutshmërinë e Rregullores së lartcekur të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, duke pretenduar se e njëjta është nxjerrë në shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 7 [Vlerat], 11 [Valuta], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 25 [E Drejta për Jetën], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], 57 [Parimet e Përgjithshme], 58 [Përgjegjësitë e Shtetit] dhe 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës, në thelb, duke theksuar që neni 35 (Valuta euro) i Rregullores së Bankës Qendrore, është në mënyrë të tërthortë diskriminues ndaj komunitetit serb në Republikën e Kosovës, ndër tjerash, "*pasi që në radhë të parë prek komunitetin serb në Kosovë [...] edhe pse vetë rregullorja nuk përmban shprehimisht dispozita diskriminuese, fakti që zbatimi i saj është diskriminues tregon diskriminim indirekt*." Parashtruesi i kërkesës thekson se nuk ka mjet juridik në dispozicion për të kontestuar ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e Rregullores së lartcekur të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

*Navodi podnosioca zahteva*

Podnosilac zahteva je pred Sudom osporio ustavnost gore navedene Uredbe Centralne banke Republike Kosovo, tvrdeći da je doneta uz povredu prava zagarantovanih u članovima 7. [Vrednosti], 11. [Valuta], 22. [Direktna primena međunarodnih sporazuma i instrumenata], 23. [Ljudski dostojanstvo], 24. [Jednakost pred zakonom], 25. [Pravo na život], 46. [Zaštita imovine], 49. [Pravo na rad i obavljanje profesije], 51. [Pravo na zdravstvenu i socijalnu zaštitu], 57. [Opšta načela], 58. [Odgovornosti države] i 59. [Prava zajednica i njihovih pripadnika] Ustava, u suštini, navodeći da je član 35. (Evro valuta) Uredbe Centralne banke indirektno diskriminatorski prema srpskoj zajednici u Republici Kosovo, između ostalog, "budući da pogađa pre svega srpsku zajednicu na Kosovu [...] iako sama uredba ne sadrži eksplicitno diskriminatorne odredbe, činjenica da je njena primena diskriminatorna ukazuje na indirektnu diskriminaciju". Podnosilac zahteva ističe da nema pravnog sredstva na raspolaganju da ospori zakonitost i ustavnost gore navedene Uredbe Centralne banke Republike Kosovo.

*Vlerësimi i Gjykatës*

Aktvendimi i Gjykatës për papranueshmëri thekson praktikën gjyqësore të konsoliduar, duke përmendur detyrimin kushtetues për shterimin e mjeteve juridike përpara se individët të mund të ngrenë shkeljet e të drejtave dhe lirive të tyre në Gjykatën Kushtetuese. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, individët duhet të shterojnë të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj për të kontestuar aktet nënligjore.

Gjykata rithekson që shterimi i mjeteve juridike është detyrim kushtetues dhe ligjor, duke theksuar kufizimet në juridiksionin e saj në raport me gjykatat e rregullta, të cilat kanë kompetencën

*Ocena Suda*

U rešenju Suda o neprihvatljivosti se ističe konsolidovana sudska praksa, navodeći ustavnu obavezu za iscrpljivanje pravnih sredstava pre nego što se pojedinci mogu pokrenuti navode o povredi svojih prava i sloboda u Ustavnom sudu. Prema Ustavu Republike Kosovo, pojedinci moraju da iscrpe sva pravna sredstva propisana zakonom kako bi osporili podzakonske akte.

Sud ponavlja da je iscrpljivanje pravnih sredstava ustavna i zakonska obaveza, ističući ograničenja u svojoj nadležnosti u odnosu na

parësore për të shqyrtuar pretendimet e individëve. Përjashtimet nga ky detyrim janë sqaruar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe janë bazuar në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Opinionet e Komisionit të Venecias. Për të përjashtuar këtë detyrim, individët duhet të argumentojnë se (i) nuk ekziston mjeti juridik; ose (ii) mjeti juridik nuk është efektiv, në dispozicion dhe/ose i qasshëm.

### *Përfundimi*

Gjykata përmes praktikës së saj gjyqësore, ka theksuar ndër vite që ligji i aplikueshëm për konflikte administrative ofron mjet juridik efektiv në rendin juridik të Republikës së Kosovës. Për më tepër, rishtazi, ajo gjithashtu përmes praktikës së saj gjyqësore, përfshirë në rastin KI10/22, me parashtrues *Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore*, ka theksuar që edhe aktet nënligjore, siç është edhe Rregullorja e kontestuar e Bankës Qendrore, i nënshtrohen kontrollit administrativ nga gjykatat e rregullta dhe që këto të fundit, kanë juridiksion të plotë që të vlerësojnë ligjshmërinë e akteve të tilla. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktvendimin për papranueshmëri, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument para Gjykatës, se përse mjetet juridike të lartcekura nuk janë efektive, në dispozicion dhe/ose të qasshme në rrethanat e rastit të tij, dhe për pasojë, Gjykata konstatoi që kërkesa duhet të shpallet e papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe pikën (b) të paragrafit 1 të rregullit 34 të Rregullores së punës së Gjykatës.

redovne sudove, koji imaju primarnu nadležnost da razmatraju navode pojedinaca. Izuzeci od ove obaveze su razjašnjeni u sudskoj praksi Ustavnog suda i zasnovani su na praksi Evropskog suda za ljudska prava i mišljenjima Venecijanske komisije. Da bi isključili ovu obavezu, pojedinci moraju da tvrde da (i) ne postoji pravno sredstvo; ili (ii) da pravno sredstvo nije efikasno, na raspolaganju i/ili dostupno.

### *Zaključak*

Sud je, kroz svoju sudsku praksu, godinama isticao da važeći zakon o upravnim sporovima pruža pravna sredstva u pravnom poretku Republike Kosovo. Pored toga, nedavno je Sud i kroz svoju sudsku praksu, uključujući i slučaj KI10/22, sa podnosiocem *Sindikat Instituta sudske medicine* naglasio da čak i podzakonski akti, kao što je osporena Uredba Centralne banke, podležu administrativnoj kontroli redovnih sudova i da poslednje navedeni imaju punu nadležnost da ocene zakonitost takvih akata. Prema pojašnjenjima datim u rešenju o neprihvatljivosti, podnosilac zahteva nije izneo nijedan argument pred Sudom zbog čega gore navedena pravna sredstva nisu delotvorna, dostupna i/ili pristupačna u okolnostima njegovog slučaja i shodno tome, Sud je utvrdio da zahtev treba da se proglasi neprihvatljivim zbog neiscrpljivanja pravnih sredstava definisanih stavom 7. člana 113. [Jurisdikcija i ovlašćene strane] Ustava, članom 47. (Individualni zahtevi) Zakona o Ustavnom sudu i sa tačkom (b) stava 1 pravila 34. Poslovnika o radu Suda.